



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:019579
Datë: 05.06.2024
Numri i dokumentit: 05783682

PAKR.nr.225/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.Ll., nga Lypjani, për shkak të veprës penale posedimi shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPK, dhe të akuzuarit U.S., nga fshati, Komuna e Lypjanit, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.221/2022, të dt.22.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.27.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.221/2022, të dt.22.01.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.221/2022, të dt.22.01.2024, janë shpallur fajtor të akuzuarit, E.Ll., për shkak të veprës penale posedimi shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe

analoge nga neni 269 par.1 të KPK, dhe i akuzuari U.S., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPK, ashtu që:

-të akuzuarit E.Ll., për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit i është shqiptuar, dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po qesë i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Në dënimin e shqiptuar me kusht, i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe nën masën e arrestit shtëpiak, nga data 31.01.2022, deri me date 29.08.2022.

Po ashtu i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 2.500 (dymijepesëqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afatin e paraparë ligjor, në kohëzgjatje prej 3 (tre)muajve, në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 Euro.

-të akuzuarit U.S., për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, i është shqiptuar dënimi me gjobë, në shumën prej 500 (pesëqind) Euro, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.31.01.2022, gjerë me dt.14.07.2022.

Janë obliguar të akuzuarit që dënimet e shqiptuara me gjobë, ti paguajnë në afat prej 3 (tre) muajve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë dënimin me gjobë, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 Euro.

Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë kohëzgjatjen më shumë se 3 (tri) vite.

Janë obliguar të akuzuarit, që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ne emër te paushallit gjyqësor shumë prej nga 50 Euro, si dhe në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, shumë prej nga 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata në mbështetje të nenit 276 par.1 dhe 2 të KPPK, si dhe nenit 269 par.3 të KPK, ka nxjerr:

Urdhër-urdhërohet konfiskimi i përhershëm, i sendeve te sekuestruara sipas:

- Vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, me nr. te rastit 2022-AH-0133, te datës 31.01.2022 si ne vijim: substancat narkotike të llojit marihuan, me peshë neto prej 0.39 gr,

- Vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, me nr. te rastit 2022-AH-0133, te datës 31.01.2022 si ne vijim: substancat narkotike të llojit marihuan, me peshë prej 1.19 gr.

Urdhërohet Policia e Kosovës- DKKO/DHTN në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të bëjë shkatërrimin (asgjësimin) e sasisë së lartpërmendur të substancës narkotike të konfiskuar (0.39 gr dhe 1.19 gr) në peshë te përgjithshme 1.58 ± 0.0001 gr, e që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2022-AH-0133, te datës 31.01.2022.

Urdhërohet që: Kartëmonedhat (1x10 euro, 12x5 euro) gjithsej 70 euro dhe telefonin e tipit “*Samsung S9*” me kodin 0000-1761996 prone e të pandehurit E.Ll., të cilat janë sekuestruar sipas Urdhëresës PPRKR.nr.68/2022, të datës 03.02.2022, t’i kthehen të akuzuarit E.Ll. pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, ankesë ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.221/2022, i dt.22.01.2024, të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, ose që i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.211/2024, të datës 11.04.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.221/2022, i dt.26.12.2023, të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar dhe mbajtur seancën e kolegjit me dt.27.05.2024, pasi që i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit ka prezantuar i akuzuari E.Ll., dhe mbrojtësja e të akuzuarit, av.Mihane Ismajli, kurse nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, përkundër asaj që është njoftuar me rregull, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësja e të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, ka deklaruar se mbetet pranë ankesë së ushtruar dhe se nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, rezulton se nuk ka prova të mjaftueshme që i akuzuari të shpallet fajtor. Sa i përket dënimit me gjobë i njëjti është i ashpër dhe propozon që ti zbutet.

I akuzuari E.Ll., deklaroi se e mbështet mbrojtjen si dhe ankesën e ushtruara.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.1 nën par.2.7 të KPPK, sepse me rasti e përpilimit të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, ka shkelur dispozitën ligjore, nga neni 384 lidhur me nenin 369 par.1 të KPK, ashtu që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me arsyetimin, është kontradiktor, i pa kuptueshëm dhe i pa qartë, ngase nuk është përpiluar sikurse kërkon dispozita përkatëse ligjore.

Gjykata e shkallës së parë, nuk ka paraqitur arsye lidhur me çdo pikë të aktgjykimit, dhe nuk ka arsyetuar se sipas të cilave fakte vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale, për të cilën është ngarkuar, ashtu që mangësitë nga neni 384 par.7 dhe 8 të KPPK, janë evidente.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara nga neni 384 i KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, nga neni 394 të KPPK.

Kolegji ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm, në harmoni me vetveten, si dhe me pjesë tjera të aktgjykimit, ngase përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 269 par.1 të KPK, e po ashtu edhe sa i përket të akuzuarit të dytë, me aktgjykim janë vërtetuar se në veprimet e të njëjtit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 269 par.2 të KPK. Gjykata e shkallës së parë është përkujdesur në mënyrë të qartë që të vërtetoj elementet inkriminuese të veprës penale, kundër të akuzuarit të parë, e po ashtu edhe kundër të akuzuarit të dytë, e kjo rezulton pas vlerësimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, si tërësi. Nga ana e gjykatës janë dhënë arsyet të mjaftueshme që në veprimet e të akuzuarit të parë qëndrojnë elementet e veprës penale të përshkruara sikurse më lartë, e po ashtu edhe sa i përket të akuzuarit të dytë, ashtu që në bazë të të gjitha provave personale, po ashtu edhe atyre materiale, është vërtetuar se në veprimet e secilit të akuzuar janë formuluar elementet inkriminuese të veprave penale që u vihen në barrë.

Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar të gjitha veprimet gjatë të gjitha fazave të procedurës, dhe ka ardhur në përfundim që të njëjtat janë ndërmarrë me përputhshmëri nga dispozitat përkatëse ligjore, ashtu që pretendimet e mbrojtëses së të akuzuarit, në këtë çështje penale nuk kanë bazë juridike, nuk ekzistojnë, pasi që gjatë punës janë vlerësuar dhe në mënyrë

të qartë dhe të plotë, janë zbatuar sikurse kërkojnë dispozitat ligjore të KPPK. Në këtë çështje penale që të gjitha institucionet të cilat kanë zhvilluar procedurë kanë përmbushur detyrimin e përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, dhe se saktësisht kanë paraqitur vërtetimin e elementeve të veprës penale, ashtu që në kuptim të nenit 364 të KPPK, me rastin e marrjes së aktgjykimit dënues, gjykata e shkallës së parë pasi që ka vërtetuar se janë formuluar elementet inkriminuese të veprës penale, për të cilën i ka shpallur fajtor të akuzuarin e parë dhe të dytë, ka ardhur në përfundim se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nuk janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimit, andaj aktgjykimi është hartuar në pajtim me dispozitën ligjore nga neni 369 par.7 i KPPK, sepse për çdo pikë të aktgjykimit janë paraqitur arsye të qarta dhe të sakta, për çdo çështje të ngritur, dhe se gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur në mënyrë të qartë saktësinë e secilës provë, e cila ka qenë domethënëse për të vendosur çështjen penale. Gjatë vlerësimit të aktgjykimit, kolegji ka ardhur në përfundim se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, janë dhënë arsyet të mjaftueshme për mos miratimin e ndonjë propozimi nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit, që kanë qenë pjesë përbërëse e formimit të elementeve inkriminuese të veprës penale.

Në rastin konkret duke pasur parasysh që i akuzuari E.Ll., është konsumues i substancave narkotike – marihuan, për këtë veprë penale, e ka shpallur fajtor dhe kolegji vie në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtësja e të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, e ka ankimuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pretenduar se i akuzuari E., ka kryer veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 269 par.1 të KPK, e jo sikurse ka qenë i akuzuar fillimisht për shkak të veprës penale blerja, shpërndarja, posedimi dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.2 lidhur me par.1 të KPK. I akuzuari E.Ll., në asnjë fazë të procedurës nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, kurse akuzohet se në trupin e tij është gjetur substancë narkotike e llojit marihuan, në peshë prej 0.39gr. mirëpo i akuzuari e ka mohuar këtë rrethanë e pasi që e ka ndalë policia, dhe e kanë kontrolluar tek ai nuk është gjetur asgjë. Kjo sasi e narkotikut të gjetur nuk paraqet bazë të mjaftueshme dhe të shërbej si provë që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga të gjitha provat e administruara asnjëra nga to nuk flasin dhe nuk vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, andaj gjykata e shkallës së parë është dashur të ketë parasysh parimin “indubio pro reo”, që të gjitha mëdyshjet që ekzistojnë në ekzistimin apo mos ekzistimin e veprës penale, ti interpretoj në favor të të akuzuarit.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkritazi me gjendjen faktike dhe ka ardhur në përfundim, se e njëjta është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe

të plotë, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ngase me të gjitha provat materiale dhe personale, me të cilat gjykata i ka proceduar dhe vlerësuar, në mënyrë të pa dyshimtë është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 269 par.1 të KPK. Po ashtu në bazë të deklaratave të cilat gjykata e shkallës së parë i ka proceduar dhe i ka vlerësuar, vihet në përfundim se në këtë çështje penale i akuzuari E.Ll., përkundër asaj që është munduar që ti shmanget fajësisë për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, ka vlerësuar edhe prova të tjera që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale, e sidomos me dëgjimin e të akuzuarit tjetër U.S., në cilësinë e dëshmitarit ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale e cila i vihet në barrë. Nga të gjitha provat materiale të cilat janë proceduar dhe vlerësuar, sikurse janë vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me numër të rastit 2022-AH-0133, të dt.31.01.2022, gjykata vërteton faktin se substanca narkotike e llojit marihuan, me peshë neto prej 0.39gr. është gjetur në trup të akuzuarit E.Ll., dhe e njëjta është konfiskuar, po ashtu edhe me leximin e vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve është vërtetuar fakti se ditën kritike, substanca narkotike e llojit marihuan, në peshë prej 1.19gr. është gjetur në trup të akuzuarit U.S.t, e që të dyja përmbajnë tetrahidrokanabinol, të cilat janë vërtetuar nga ekzaminimi i bërë nga ana e agjencisë për forenzikë, sipas raportit me numër AKF2022-0723/2022-695, të dt.03.03.2022, leximi i procesverbalit përkitazi me pronën me numër të rastit 2022-AH-033, të dt.03.01.2022, sipas të cilit vërtetohet se kartëmonedha 1x10Euro, 12x5Euro, githësjet në shumën prej 70Euro dhe telefoni i tipit “Samsung S9”, me kodin 0000-1761996, janë sekuestruar nga i akuzuari E.Ll., sipas urdhëresës PPRKR.nr.68/2022, të dt.03.02.2022. telefoni i tipit “Samsung”, është konfiskuar me qëllim të verifikimit dhe ekzaminimit të të njëjtit për sigurinë e provave të mëtejme. Po ashtu me leximin e raportit të ekspertizës nga agjencia e Kosovës për Forenzikë, me numër AKF/2022-0723/2022-695, të dt.03.03.2022, vërtetohet se substanca e sekuestruar përputhet me vërtetimet e më sipërme, e cila është kompatible edhe me dokumentacionin tjetër nga shkresat e lëndës. Që të gjitha këto prova në mënyrë të pa dyshimtë kanë vërtetuar se në veprimet e secilit të akuzuar, janë formuluar elementet qenësore të veprës penale, sikurse për të akuzuarin e parë, po ashtu edhe për të akuzuarin e dytë.

Pasi që i akuzuari i parë, nuk ka bërë shitjen e substancës narkotike, gjykata e shkallës së parë, drejt ka vendur kur ka bërë rikualifikimin juridik të veprës penale nga neni 267 par.1 në nenin 269 par.1 të KPK, dhe kolegji është i bindur se në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, në këtë çështje penale dhe gjykata e shkallës së parë, drejt ka vendosur kur secilit të akuzuar e ka shpallë fajtor dhe i ka shqiptuar sanksionin penal, përkatës.

Përkundër asaj, që nga ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin dhe analizuar sipas detyrës zyrtare dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vlerësuar dhe ardhur në përfundim që në veprimet e secilit të akuzuar, janë formuluar elementet qenësore të veprës penale, për të cilën janë shpallur fajtor, e po ashtu ka vlerësuar se aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, në kuptim të nenit 385 të KPPK.

Kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, atëherë ka vlerësuar se vepra penale për secilin të akuzuar është e paraparë me ligjin e aplikueshëm, se nuk ka gjetur arsye të cilat e përjashtojnë të akuzuarin e parë dhe të dytë, nga ndjekja penale, si dhe përgjegjësia penale, se gjatë marrjes së vendimit për dënimin, dënimin plotësues, gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal.

Edhe për shkak të vendimit për dënimin, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, duke theksuar se në këtë çështje penale dënimi me gjobë është i lartë, dhe se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në masë të duhur të gjitha rrethanat për marrjen e vendimit sa më të drejtë, ashtu që me këtë lloj dënimi nuk pritet që të arrihet efekti dhe qëllim i dënimit.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit E.Ll., av.Mihane Ismajli, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila rezulton pasi që janë vlerësuar të gjitha provat, sikurse personale dhe ato materiale, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPK. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin e parë, ka pasur parasysh karakteristika personale të të akuzuarit, se i njëjti është i martuar, familjar, se punon herë pas here, kurse si rrethana rëndues ka pasur parasysh se i njëjti ka qenë i dënuar me aktgjykimet, si në vijim, aktgjykimi P.nr.350/2021, i plotfuqishëm me dt.05.12.2022, aktgjykimi P.nr.533/2021, i plotfuqishëm me dt.10.02.2023, aktgjykimi P.nr.178/2022, i plotfuqishëm me dt.15.07.2022, aktgjykimi P.nr.1066/2017, i plotfuqishëm me dt.18.07.2022, aktgjykimi P.nr.323/2020, i plotfuqishëm me dt.05.04.2021, aktgjykimi P.nr.975/2020, i plotfuqishëm me dt.09.03.2021, dhe aktgjykimi P.nr. 173/2019, i plotfuqishëm me dt.23.01.2020.

Po ashtu ka pasur parasysh me rastin e shqiptimit të vendimit për dënimin për të akuzuarin e dytë U.S., se i njëjti ka pranuar veprimet inkriminuese, por jo me përkrahje të veprës penale, duke theksuar se substanca narkotike, ka qenë më pak se 3gr, se është hera e parë që ka ara në kundërshtim me ligjin, e po ashtu sa i përket të akuzuarit të parë dhe të dytë, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale nga secili i akuzuar, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës.

Nga ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E.Ll., av.Miane Ismajli, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, epo ashtu edhe ka vlerësuar aktgjykimin edhe për të akuzuarin U.S., dhe ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar secilit të akuzuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tyre, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.225/2024, të datës 27.05.2024

**Procesmbajtës,
Endrit Ajeti**

**Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi**

Kadrije Goga Lubishtani